**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. 02/646

Date: 18.07.2023

Në mbështetje të neneve 53 dhe 57 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas neneve 4 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**

1. Themelohet ekipi i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit 2022 të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Komunën e Shtimes.

2. Ekipi i implementimit të rekomandimeve nga Raporti i Auditimit formohet në këtë përbërje:
    1. Bujar Ferati – Kryesues
    2. Kimete Ukaj – anëtar
    3. Minire Halili – anëtar
    4. Hysen Hyseni – anëtar
    5. Kastriot Shabani – anëtar
    6. Grejtalb Emini – anëtar
    7. Valon Januzi – anëtar
    8. Jeton Raka – anëtar
    9. Bardhyl Rushiti – anëtar
    10. Gazmend Hysenaj – anëtar
    11. Idriz Hasani – anëtar
    12. Merita Emini – anëtare
    13. Albana Fazliu – anëtare
    14. Lulzim Sahiti – anëtar
    15. Isa Haxhiu – anëtar
    16. Lulzim Sahiti – anëtar
    17. Jetush Rrafshi – anëtar

3. Ekipi vepron në pajtim me detyrimet ligjore të përcaktuara sipas Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, për t'i përmbushur rekomandimet e dalura nga Raporti i Auditimit për Komunën e Shtimes për vitin 2022.

4. Konkretisht, detyrat e ekipit përfshijnë:
    1. Pranimin e Planit të Veprimit të dorëzuar në ZKA për implementimin e rekomandimeve;
    2. Hartimin e veprimeve konkrete për implementim të rekomandimeve;
    3. Monitorimin e plotë të nivelit të përmbushjes së rekomandimeve;
    4. Raportimi te Kryetari për procesin e implementimit të rekomandimeve;
    5. Hartimin e Rapotit për Ministrinë e Financave dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit sipas nenit 14 të Rregullores nga ZKA (dy herë në vit, deri më 30 shtator dhe 15 mars).

5. Përmes këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi nr. 02/302 i datës 05.07.2022

6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu

*Iu dërgohet:*
*Anëtarëve të Ekipit*
*Arkivit*